

# Fundi i getoizimit të Ballkanit Perëndimor – Liberalizimi i vizave

## Rezyme

Që në Maj të vitit 2008 kur u bë shpallja e Hartës për liberalizim të vizave nga Komisioni evropian për qeverinë e Maqedonisë, liberalizimi i vizave është shëndërruar në temë të vitit. Pas raportimeve të shumta dhe mbulesës së madhe nga ana e mediave si dhe eksplotimit politik të kësaj teme, ky raport synon të prezentojë imazh kompakt mbi tërë procesin e deritanishëm.

Vlerësimi i KE dhe propozimi i tij për ndryshimin e rregullores 539/2001 u shpall gjatë presidences Çeke. Sidoqoftë, Komisioni në planin e tij më të detajuar të vitit 2009 planifikon këtë ndryshim për në Shtatorin e vitit 2009. Mirëpo, ekziston mundësia që kjo të mbetet e pandryshuar për shkak të zgjedhjeve në UE.

Nga ajo që është bërë në rastin e Maqedonisë, mund lehtë të shihet se të gjitha kriteret janë përmbushur. Maqedonia mund të bëjë përpjekje të mëtutjeshme në përforcimin e kapaciteteve administrative dhe teknike. Sidoqoftë, marrë parasysh që misionet speciale si dhe takimet kanë përfunduar, si dhe faktin që nuk ka ngelur shumë hapësirë për përmbushje të kriterëve, ne nuk jemi në gjendje të japim rekomandime lidhur me detajet teknike të procesit. Megjithatë, ekzistojnë hapa të cilët mund të merren në konsideratë si nga qeveria e Maqedonisë ashtu edhe nga UE-ja.

### Në anën e Unionit Evropian:

- ✪ Gjatë formulimit të vlerësimeve mbi Hartën, Komisioni evropian duhet të marrë në konsideratë:
  - Të kaluarën historike të udhëtimeve të shumicës së shteteve të Ballkanit perëndimor, si një faktor që çështjen e vizave e bën të rëndësishme dhe urgjente;
  - Të marrë parasysh seriozisht faktin që kjo para së gjithash nuk është hyrje në zonën e Shengenit por eliminim të barrierave që ekzistojnë ndërmjet njerëzve të Ballkanit perëndimor dhe njerëzve nga UE-ja, gjë që është në përputhje me deklaratat e UE-së për përforcim të kontakteve ndër - njerëzore.
- ✪ Komisioni evropian duhet të rekomandojë ndryshimin e rregullores 539/2001 duke avansuar vendet e Ballkanit perëndimor të cilat kanë plotësuar kushtet e parashtruara në Hartën për liberalizim, një nga një ose një grup shtetesh nga Aneksi I dhe II. Duhet të mbahet premtimi i dhënë se të gjitha shtetet do të vlerësohen në bazë të të arriturave individuale. Duke marrë parasysh vlerësimet aktuale, si dhe shenjat që vijnë nga rajoni, Maqedonia është një lider në rajon, dhe kështu duhet të vendoset në Listën e bardhë. Çdo shtet tjetër që ka plotësuar kërkesat lidhur me udhëzimet e parashtruara duhet gjithashtu të vendoset në këtë Listë. Momentalisht, pranë Maqedonisë qëndrojnë edhe Serbia dhe Mali i Zi. Marrë parasysh pozicionin e liderit të Maqedonisë, i pranuar gjerësisht nga rajoni dhe Brukseli që në fillim, çdo vendim ndryshe nga dhënia e liberalizimit të plotë të vizave do të nënkuptonte rrënim të kredibilitetit të këtij procesi. Shpërblimi i përpjekjeve të Maqedonisë në këtë aspekt është i detyrueshëm. Kjo do të tregonte që UE-ja realizon premtimet e dhëna kur shtetet plotësojnë kriteret e vendosura.

- ✦ Komisioni evropian duhet të evitojë bërjen e planeve opcionale, që do të nënkuptonin vetëm liberalizim të pjesërishtëm të regjimit të vizave për këto shtete. Duhet që të realizojë me përpikmëri atë që u është premtuar këtyre vendeve - udhëtim pa viza për qytetarët e këtyre shteteve në varësi të përmbushjes së kushteve që dalin nga Harta e liberalizimit.
- ✦ Këshilli i UE-së dhe Parlamenti i UE-së duhet të pranojnë propozimin nga KE në avancimin e shteteve nga Ballkani Perëndimor të cilat do të marrin vlerësime pozitive nga Komisioni evropian.
- ✦ Duhet të punohet në përmirësimin e Lehtësimit të vizave me shtetet të cilave nuk do t’u jepen rekomandime për t’u futur ne Listën e bardhë.
- ✦ Të përkrahen përpjekjet për të mbajtur hapur kufijtë ndërmjet shteteve fqinje në Ballkan, edhe nëse disave prej tyre nuk u jepet liberalizim i vizave.

### **Në anën e qeverisë së Maqedonisë:**

- ✦ Çka mund të bëhet:
  - Maqedonia mund të vazhdojë të punojë në përmirësimin e fushave që përfshihen në Hartë si: përforcimi i kapaciteteve administrative, përmirësimi i kapaciteteve teknike, ratifikimi dhe implementimi i dokumenteve me rëndësi për këtë proces. Duhet që gjithashtu të punohet në përmirësimin e koordinimit ndër-ministror, posaçërisht në aspekt të implementimit të Marrëveshjes për lehtësim të vizave.
  - Duhet një angazhim i madh në përmirësimin e procesit të Lehtësimit të vizave. Fundja, në rast të mosdhënies së Liberalizimit të vizave Maqedonisë, qytetarët e Maqedonisë do jenë të detyruar edhe më tej të parashtrojnë kërkesa për viza.
- ✦ Në rast se Maqedonisë i dorëzohet Liberalizimi i vizave:
  - Nuk duhet që liberalizimi i vizave të përdoret si marketing politik. Avansimet e shënuara në Hartë janë fryt i më shumë qeverive dhe jo vetëm i qeverisë aktuale.
  - Duhet të informohen qytetarët mbi atë se çka në të vërtetë nënkupton liberalizimi i vizave, beneficionet që dalin nga ky proces si dhe obligimet e qytetarëve që udhëtojnë në UE.
  - Të shpërndahet eksperiencia pozitive e Maqedonisë në rajon e cila do të shërbente si model për vendet tjera të rajonit.
- ✦ Në rast se Maqedonisë nuk i dorëzohet Liberalizim i vizave:
  - Vendimi duhet të pritët me kokëftohtësi dhe të riafirmohet përkushtimi i Maqedonisë drejt arritjes së këtij synimi.